



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

01, 634

23. 10. 2015

Në bazë të nenit 4 pika 1.15 dhe nenit 15 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nxjerr këtë

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2015
PËR CAKTIMIN E SHPENZIMEVE TË REPREZENTACIONIT**

**Neni 1
Qëllimi**

- 1.1. Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim menaxhimin më efikas të buxhetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK), përcaktimin e procedurave dhe lartësisë së shpenzimeve të reprezentacionit përmenaxhmentin e gjykatave, respektivisht kryetarët e gjykatave dhe menaxhmentin e KGjK duke përfshirë edhe udhëheqësit e njësive të KGjK-së.
- 1.2. Zyrtarëve të caktuar me këtë Udhëzim u lejohen shpenzime të reprezentacionit, me qëllim të kryerjes së punëve dhe detyrave në kuadër të përgjegjësive të tyre.

**Neni 2
E drejta ne shfrytëzimin e fondit për reprezentacion**

- 2.1. Të drejtë në shpenzime të reprezentacionit kanë:
 - 2.1.1 kryesuesi i KGjK-së dhe kryetari i Gjykatës Supreme,
 - 2.1.2 kryetari i Gjykatës se Apelit, kryetarët e gjykatave themelore, drejtori i Sekretariatit të KGjK-së, drejtori i Njësitet për shqyrtimin e performancës se së gjyqësorit, dhe drejtori i Zyrës se prokurorit disiplinor, dhe
 - 2.1.3 gjyqtarët mbikëqyrës të degëve dhe udhëheqësit e njësive të KGjK.

**Neni 3
Shpenzimet e reprezentacionit**

- 3.1. Shpenzimet e reprezentacionit përfshijnë të gjitha shpenzimet që bëhen gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave zyrtare, si në vijim:
 - 3.1.1 për pozitat sipas nenit 2.1.1 dhe 2.1.2 të këtij Udhëzimi, shpenzimet përfshijnë pijet gjatë takimeve zyrtare, drekat ose darkat zyrtare me delegacione te ndryshme dhe me përfaqësues te gjykatave apo institucioneve tjera;

3.1.2 për pozitat sipas nenit 2.1.3 të këtij Udhëzimi, shpenzimet përfshijnë pjet gjatë takimeve zyrtare me delegacione te ndryshme ose përfaqësues të institucioneve tjera.

- 3.2 Shpenzimet e reprezentacionit nuk mund të përdoren pre qëllime të tjera, përvèç atyre te përcaktuara më lartë.

Neni 4
Lartësia dhe lloji i shpenzimeve të reprezentacionit

- 4.1 Në varësi nga arsyet dhe nevojat e punës, vlera maksimale mujore e shpenzimeve mujore të reprezentacionit është si në vijim:
- 4.1.1 për pozitat sipas nenit 2.1.1 të këtij udhëzimi vlera maksimale nuk është e përcaktuar, që do te thotë se është pa kufizim, derisa shpenzimet përfshijnë pjet gjatë takimeve zyrtare, drekat ose darkat zyrtare me delegacione te ndryshme dhe me përfaqësues te gjykatave apo institucioneve tjera;
- 4.1.2 për pozitat sipas nenit 2.1.2 të këtij udhëzimi vlera maksimale është 300 Euro, derisa shpenzimet përfshijnë pjet gjatë takimeve zyrtare, drekat ose darkat zyrtare me delegacione te ndryshme dhe me përfaqësues te gjykatave apo institucioneve tjera; dhe
- 4.1.3 për pozitat sipas nenit 2.1.3 të këtij udhëzimi vlera maksimale është 100 Euro, derisa shpenzimet përfshijnë pjet gjatë takimeve zyrtare me përfaqësues te gjykatave apo institucioneve tjera.

Neni 5
Shpenzimet e reprezentacionit për komisionet dhe grupet punuese

- 5.1 Udhëheqësve te komisioneve dhe grupeve punuese të KGjK-së u lejohen shpenzimet e reprezentacionit pas aprovimit nga Drejtori i SKGjK-së.
- 5.2 Komisioneve dhe grupeve punuese të KGjK-së u lejohen shpenzimet e reprezentacionit ne shumën e caktuat "*ad hoc*", sipas kërkesës së udhëheqësit te komisionit apo grupit punues dhe pas aprovimit nga Drejtori i SKGjK-së.

Neni 6
Përdorimi i shpenzimeve të reprezentacionit

- 6.1 Shpenzimet e reprezentacionit përdoren vetëm për mbulimin e shpenzimeve të takimeve zyrtare dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera.
- 6.2 Të gjitha shpenzimet e reprezentacionit duhet të arsyetoohen me fatura përkatëse dhe të nënshkruara nga shpenzuesi.

Neni 7
Shpenzimet e reprezentacionit dhe arsyetimi i tyre me faturim

- 7.1 Të gjitha shpenzimet e reprezentacionit që kalojnë shumën e përcaktuar dhe që janë në kundërshtim me dispozitat paraprake të këtij Udhëzimi Administrativ do të mbulohen nga vetë zyrtari i cili e ka tejkaluar shumën e përcaktuar.
- 7.2 Shpenzimet e reprezentacionit të faturuara deri në 100 Euro në muaj mund të paguhen me para në dorë, nga mjetet e imta të parave të gjykatës përmes zyrtarit të autorizuar.

Neni 8
Akumulimi i shpenzimeve të reprezentacionit

- 8.1 Shpenzimet e reprezentacionit nuk mund të akumulohen dhe vlera e shpenzimeve mbyllt në ditën e fundit të muajit kur janë bërë shpenzimet.
- 8.2 Faturat e mbledhura gjate muajit dorëzohen ashtu si janë realizuar, dhe ne zbatim te paragrafit te mësipërm nuk pranohet një apo me shume fatura të cila përbajnjë shpenzime të reprezentacionit të tërë muajit.


Neni 9
Planifikimi i shpenzimeve të reprezentacionit

Departamenti për Buxhet dhe Financa në SKGJK duhet t'i planifikojë dhe aprovojë në buxhetin e viti fiskal të organizatës buxhetore shpenzimet e reprezentacionit me kod të veçantë për shpenzime të reprezentacionit.

Neni 10
Hyrja në fuqi

- 10.1 Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet vendimi i datës 02.01.2007 i SKGJK-së, dhe çdo dhe akt tjetër i cili ka rregulluar më parë këtë çështje.
- 10.2 Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Prishtinë, 23/10/ 2015



Enver Peci,

Kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës